



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.10.2020)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje shtesë të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 11. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënie leje shtesë të papaguar”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Duke qenë se të gjithë anëtarët janë të pranishëm, po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 28 tetor 2020.

Siç jeni në dijeni, në këtë rend dite janë përfshirë 7 çështje, për të cilat kërkohet vendimmarrje e KLGJ-së. Konkretisht kemi çështjen e parë shqyrtimi i projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtarës {...} për dhënie leje shtesë të papaguar”.

Çështja e dytë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e modelit të hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”.

Çështja e tretë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar z. {...}”.

Çështja e katërt ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Çështja e pestë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin e kandidatit z. {...} për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021”;

Çështja e gjashtë është shqyrtimi i projektvendimit për kualifikimin e kandidatës znj. {...}, për në Programin e Formimit Fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për

magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021;

Çështja e fundit është ceremonia e betimit të gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020.

Jemi dakord me rendin e ditës?

(Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime, janë dakord.)

Atëherë, fillojmë me çështjen e parë e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për refuzimin e kërkesës së gjyqtares {...} për dhënie leje shtesë të papaguar”. Relatore e kësaj çështjeje është zonja Brunilda Kadi.

Brunilda Kadi: Faleminderit!

Gjyqtarja {...}, që ushtron funksionin pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, në datë 09.10.2020 ka paraqitur nëpërmjet postës elektronike kërkesë për leje shtesë pa të drejtë page për një periudhë 1-vjeçare, kërkesë të cilën, sipas përmbajtjes së këtij e-maili e ka nisur edhe në rrugë postare, por që deri në këtë moment nuk ka mbërritur pranë Këshillit.

Në kërkesën nëpërmjet postës elektronike zonja {...} parashtron, dhe unë nuk po e citoj, ju e keni të gjithë relacionin, edhe për arsye që tek kjo parashtrësë ka informacion me përmbajtje private në lidhje me gjyqtaren, kështu që vlerësoj që të mos ta lexoj derisa seanca regjistrohet me audio.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, fillimisht vlerësoi se, për shkak të rrethanave dhe urgjencës së trajtimit, të vijojë me trajtimin e kësaj kërkesë, edhe pse ajo ka mbërritur pranë Këshillit vetëm në formën e postës elektronike.

Për sa i përket shqyrtimit në themel të kësaj kërkesë, nga ana e Komisionit, vlerësohet se: Në datën 09.02.2018, me vendimin nr. 26, KLD në atë kohë i ka akorduar gjyqtares një leje për shpëputje të përkohshme nga puna për arsye shëndetësore familjare, leje e cila fillonte në 01.04.2018 dhe përfundonte në 31.03.2020.

Bazuar në rrethanat faktike dhe kuadrin ligjor që rregullon këtë situatë, Komisioni vlerëson se kërkesa e gjyqtares për t'i dhënë leje të paguar shtesë, edhe për një vit, është e pabazuar në ligj.

Bazuar në nenin 24 të Ligjit nr. 96/2016 (nuk po e citoj përmbajtjen e ligjit) por edhe në vendimin nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, afati maksimal për

të marrë leje të papaguar për arsye familjare ose shëndetësore sipas këtyre rregullimeve është 2 vjet. Nga ana e gjyqtares, ky afat maksimal i është dhënë në lejen e KLD-së së sipërcituar dhe është konsumuar prej saj.

Nga ana tjetër, edhe arsyeja që referon gjyqtarja, që është pamundësia për të udhëtuar nga SHBA në Shqipëri, nuk është nga rastet që ligji parashikon si mundësi për magjistratin për të marrë lejë të papaguar.

Në e-mailin e sipërcituar, gjyqtarja pretendon se me shkresën e datës 20.03.2020 dhe me e-mailin e dërguar në adresën elektronike zyrtare, ka vënë në dijeni Këshillin për pamundësinë e paraqitjes së saj në detyrë në datë 1 prill 2020, kohë kur mbaronte dhe leja 2-vjeçare e akorduar nga ish-KLD, për shkak se situata e pandemisë e gjeti jashtë vendit.

Bazuar në nenin 23, pika 10 të ligjit 96/2016, i ndryshuar, Këshilli ka vlerësuar në atë moment, dhe nga ana e Komisionit parashtrohet përsëri këtu, që në lidhje me këtë pretendim, kompetencën për të vlerësuar mungesën e justifikuar në detyrë, nuk e ka Këshilli por kryetari i gjykatës në të cilën gjyqtari ushtron funksionin.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 24 të Ligjit nr. 96/2016 dhe vendimit nr. 72, datë 20.05.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Komisioni propozon:

1. Refuzimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë për dhënie leje shtesë të papaguar për një periudhë 1-vjeçare.
2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, kemi ndonjë diskutim lidhur me projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në procedurën e votimit.

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Refuzimin e kërkesës së znj. {...}, gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, për dhënie leje shtesë të papaguar për një periudhë 1-vjeçare.

2. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtares {...} dhe Gjykatës së Apelit Tiranë.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimitetit.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.10.2020)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e modelit të hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 2. Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 3. Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
- 4. Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
- 5. Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
- 6. Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e modelit të hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit””, përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë të rendit të ditës, e cila ka të bëjë me miratimin e modelit të hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, i cili është përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do relatohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në zbatim të Ligjit “Për statusin”, i ndryshuar, ka miratuar një sërë aktesh nënligjore që plotësojnë Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve. Një nga këto akte është vendimi nr. 263, datë 21.11.2019, me anë të së cilit janë miratuar rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve. Në këtë vendim është parashikuar që dy prej akteve të rëndësishme që finalizojnë punën e vlerësuesve, raporti analitik dhe projekt-raporti i vlerësimit, të përpilohen sipas një forme standarde, një modeli që duhet të miratohet nga Mbledhja Plenare.

Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, i mbështetur nga Njësia e Vlerësimit Profesional, njësi mbështetëse e këtij Komisioni, po vazhdon punën për përfundimin e raporteve të para të vlerësimit. Nga puna e kryer deri tani kemi konkluduar në këtë model të formës standarde të raportit analitik, raport ky që shoqëron projekt-raportin e vlerësimit, e që ju propozohet sot për miratim, bazuar në nenin 90, pika

2 të Ligjit për Statusin dhe nenit 14, pika 3 të Vendimit nr. 263, datë 21.11.2019.

Hartimi i modelit mbi bazën e të cilit do të hartohet raporti analitik nga nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, ka për qëllim standardizimin e mënyrës së hartimit të këtij raporti, përfshirjen e të gjitha burimeve të vlerësimit, evidentimin në mënyrë të strukturuar të të dhënave që rezultojnë prej tyre në raport me treguesit që i përkatësin secilit nga katër kriteret e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit, si dhe përcaktimin e përmbajtjes që duhet të ketë raporti për çdo tregues, duke përcaktuar sipas treguesit, nëse nëpunësi duhet të evidentojë të dhënat nëpërmjet përshkrimit dhe/ose analizës së tyre.

Modeli i raportit analitik është konceptuar si një dokument i integruari ndarë në katër pjesë (Nënndarja A, B, C dhe D), si më poshtë:

Nënndarja A përmban të dhënat e gjyqtarit.

Në këtë nënndarje pasqyrohen të dhënat personale të gjyqtarit subjekt vlerësimi, të dhënat e kontaktit, gjykata ku ushtron funksionin dhe, sipas rastit, seksioni përkatës si dhe periudha e vlerësimit për të cilën hartohet raporti.

Nënndarja B përmban qëllimin e raportit.

Në këtë nënndarje pasqyrohet qëllimi i hartimit të raportit analitik si akt ndihmës në procesin e vlerësimit etik dhe profesional, i cili ka për qëllim, renditjen e të gjitha burimeve të vlerësimit, paraqitjen e të dhënave që rezultojnë nga burimet duke i përshkruar dhe analizuar sipas rastit, në varësi të kriterëve të vlerësimit dhe treguesve përkatës. Ky raport analitik shoqëron në çdo rast projekt-raportin e vlerësimit dhe strukturohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë punën e relatorit duke i bërë të dhënat lehtësisht të shfrytëzueshme.

Nënndarja C përmban burimet e vlerësimit.

Në këtë pjesë listohen të gjitha burimet e vlerësimit të cilat administrohen në dosjen e vlerësimit për gjyqtarin subjekt vlerësimi, sipas parashikimeve të nenit 77 të Ligjit për Statusin.

Nënndarja D ka për qëllim pasqyrimin dhe/ose analizën e të dhënave të burimeve të vlerësimit, në varësi të kriterëve të vlerësimit.

Për çdo kriter vlerësimi është përcaktuar se çfarë duhet të përmbajë raporti analitik duke iu referuar parashikimeve të nenit 90 pika 2 të Ligjit për Statusin, në të cilin parashikohet se: “Çdo akt i marrë gjatë procedurës së vlerësimit, sipas këtij ligji, përfshihet në dosje dhe listohet në një raport, i cili analizon në mënyrë të detajuar dhe të

strukturuar të dhënat”. Ndërkohë, në nenin 14, pika 3 të Vendimit nr.263, datë 21.11.2019 parashikohet se: “...Raporti analitik përmban listën e akteve të mbledhura në procesin e vlerësimit, si dhe analizon në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar të dhënat nga aktet e dosjes së vlerësimit”.

Kjo nënndarje e raportit analitik është organizuar sipas katër grup kriterëve mbi të cilat do të bëhet vlerësimi etik dhe profesional i gjyqtarit dhe konkretisht: “Aftësitë profesionale”; “Aftësitë organizative”; “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale” dhe “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”.

Për secilin nga katër kriteret janë përcaktuar rubrikat sipas treguesve, të cilët i referohen metodologjisë së miratuar. Për çdo tregues, është përcaktuar listimi i burimeve të vlerësimit dhe përshkrimi i të dhënave, i shoqëruar sipas rastit, edhe nga analiza e tyre. Nëpunësi bën analizën e të dhënave burimore, në raport me elementët që përmban secili tregues sipas metodologjisë, vetëm në ata tregues ku shpjegohet në mënyrë narrative në model.

Përcaktimi i mënyrës se si të do të pasqyrohen në raportin analitik të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, ndjek strukturën e përcaktuar në Metodologjinë e Pikëzimit, miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019. Kjo mënyrë strukturimi i shërben qëllimit që ka vetë raporti analitik, si një akt ndihmës për hartimin e projekt-raportit të vlerësimit nga relatori.

Pas referimit të treguesit, është parashikuar listimi i burimeve të vlerësimit, të ndryshëm për tregues të caktuar. Më pas bëhet nëpërmjet përshkrimit dhe/ose analizës, evidentimi i të dhënave që rezultojnë nga secili burim.

Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale të gjyqtarit, është parashikuar listimi i burimeve të vlerësimit për çdo tregues, si dhe pasqyrimi në mënyrë të detajuar i të dhënave që rezultojnë nga secili burim, pa bërë analizë dhe vlerësim të tyre. Kjo pasi analiza e të dhënave në lidhje me kriterin e aftësive profesional, duke iu referuar burimeve të vlerësimit për këtë kriter, ndërthuret me elemente të vlerësimit të të dhënave, të cilat janë kompetencë e relatorit. Për këtë arsye, në treguesit e kriterit të aftësive profesionale të gjyqtarit, është përcaktuar që nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, të bëjë vetëm përshkrimin e detajuar të të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pa bërë analizë të tyre.

Në lidhje me kriterin e aftësive organizative të gjyqtarit, duke iu referuar natyrës

së treguesve si dhe natyrës së burimeve të vlerësimit (të dhënat statistikore, vetëvlerësimi i gjyqtarit, mendimi i kryetarit) është përcaktuar se raporti duhet të përmbajë veç pasqyrimin, edhe analizën e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit. Për çdo tregues, parashikohet listimi i burimeve të vlerësimit dhe pasqyrimi i të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi dhe analiza e të dhënave.

Për kriterin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, parashikohet vetëm listimi i burimeve të vlerësimit dhe pasqyrimi në mënyrë të detajuar i të dhënave që rezultojnë nga çdo burim, për secilin tregues të këtij kriteri. Në lidhje me integritetin, evidentimi bëhet bazuar në prezumimin se gjyqtari ka integritet.

Për kriterin e aftësive personale dhe angazhimit profesional, parashikohet pasqyrimi dhe/ose analiza e të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, sipas natyrës së treguesit dhe llojit të burimeve.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit është parashikuar miratimi i formës standarde të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur.

Në referim të nenit 97 shkronja “ç” dhe 98, pika 4 të Ligjit nr. 115/2016, është parashikuar hyrja në fuqi e këtij akti, në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Ukperaj!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e tij sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Miratimin e modelit të hartimit të “Raportit analitik për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit”, sipas formatit bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Modeli i këtij raporti analitik miratohet në formatin shkresor.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.10.2020)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Maksim Qoku*** (zëvendëskryetar)
3. ***Medi Bici*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Brunilda Kadi*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ilir Toska*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Brikena Ukperaj*** (anëtar)
10. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
11. ***Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

12

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 28.10.2020 (Pika 3)***

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtore pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin {...}, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar z. {...}”, përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtarin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar z. {...}. Për më shumë detaje fjalën po ia jap zonjës Shehu për relativim.

Marçela Shehu: Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 22.10.2020 është depozituar një kërkesë nga gjyqtari i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, z. {...}, nëpërmjet të cilës ai ka parashtruar dorëheqjen e tij nga statusi i magjistratit.

Në kërkesën e tij, gjyqtari z. {...} ka kërkuar të heqë dorë në mënyrë të parevokueshme nga statusi i gjyqtarit dhe nga funksioni i gjyqtarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, duke parashtruar që dorëheqja e tij të trajtohet si dorëheqje me efekte të menjëhershme konform nenit 65, pika 3 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Si motiv të dorëheqjes së tij, z. {...} ka parashtruar angazhimin e tij në një pozicion pune jashtë sistemit gjyqësor, konkretisht në pozicionin e juristit pranë Shoqërisë “Marceli” sh.p.k., pozicion pune që i ishte ofruar më datë 15.10.2020, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së punës me këtë shoqëri, efekte që në bazë të kontratës fillojnë më datë 30.10.2020.

Për rrjedhojë, z. {...} i ka kërkuar Këshillit miratimin e dorëheqjes dhe dhënien e efekteve të saj, përpara datës 30.10.2020, ditë kur do të duhet të fillojë punë pranë Shoqërisë “Marceli” sh.p.k.

Më poshtë, relacion, janë edhe të dhënat lidhur me magjistratin, arsimimin e tij, fillimin e marrëdhënieve të tij të punës.

Lidhur me kërkesën e paraqitur, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe unë me cilësinë e relatores, kam vlerësuar se shkak i paraqitur nga magjistrati përbën një shkak të justifikuar, i tillë, për t’i dhënë efektet e dorëheqjes përpara kohës së përcaktuar në pikën 2 të nenit 65 dhe në këto kushte i kërkoj Këshillit të Lartë Gjyqësor, i propozoj të deklarojë mbarimin e statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për shkak të dorëheqjes së tij të motivuar nga ky status dhe efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.10.2020.

Është përgatitur edhe projektvendimi përkatës.

Ju sjell në vëmendje që shkak i referuar nga zoti {...} si shkak i justifikuar për të dhënë efektet e menjëhershme dorëheqjes së tij është pranuar tashmë nga Këshilli edhe në raste të tjera dhe përbën një standard të Këshillit, si një shkak që për ligj aplikimin e nenit 65, pika 3 e ligjit për Statusin. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zonja Shehu!

Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në miratimin e projekt-akti?

Maksim Qoku: Kundër. Për të njëjtat arsye dhe qëndrimet që kam mbajtur në lidhje me këto argumente në çështjet e kaluara, mendime të cilat edhe i kam depozituar me shkrim.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1. Deklarimin e mbarimit të statusit të magjistratit për z. {...}, gjyqtar i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, për shkak të dorëheqjes së tij nga ky status.

2. Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 30.10.2020.

3. Një kopje e këtij vendimi i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.10.2020)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:00 dhe mbaroi në orën 11:40.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Maksim Qoku** (zëvendëskryetar)
- 3. Medi Bici** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)
- 5. Brunilda Kadi** (anëtare)
- 6. Dritan Hallunaj** (anëtar)
- 7. Ilir Toska** (anëtar)
- 8. Alban Toro** (anëtar)
- 9. Brikena Ukperaj** (anëtar)
- 10. Marçela Shehu** (anëtare)
- 11. Erjon Muharremaj** (anëtar)

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Helena Papa, Drejtoresh pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
3. *Pjerin Prendi, Këshilltar pranë Kabinetit të Kryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
4. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
5. *Entela Dobi, Përfaqësuese e Ministrisë së Drejtësisë.*
6. *Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një shtesë në vendimin nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me një shtesë të vendimit nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”, çështje që propozohet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga zoti Toska.

Ilir Toska: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur një projektvendim përmes të cilit i propozohet Këshillit që të bëjë një shtesë në vendimin nr. 205, datë 11.06.2020 “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Lidhur me këtë projektvendim është përgatitur edhe relacioni shpjegues. Shkurtimisht po parashtroj:

Me Vendimin nr.205, datë 11.06.2020, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur:

“1. Gjyqtarit {...}, aktualisht gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, i përsëritet transferimi i përkohshëm, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, për një periudhë deri në 1 (një) vit.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 22.06.2020.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë. ...”

Në këtë vendim, Këshilli nuk ka përcaktuar njësinë buxhetore që do të përballojë efektet financiare sipas këtij vendimi, që në këtë rast kanë të bëjnë me pagimin e pagës për gjyqtarin e transferuar përkohësisht.

Sipas informacionit të marrë nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit, referuar informacionit të marrë nga nëpunësi zbatues i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, rezulton se efektet financiare të vendimit si më lart të Këshillit po përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, si gjykata ku gjyqtari i transferuar po ushtron funksionin dhe në kushtet kur Këshilli nuk ka përcaktuar një rregullim të ndryshëm sa i përket përballimit të efekteve financiare të vendimit.

Ndërkohë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë ka në organikën e saj 4 gjyqtarë. Në fakt, në këtë gjykatë, ka të caktuar në mënyrë të përhershme 3 gjyqtarë, nga të cilët vetëm një prej tyre ushtron detyrën aty. Ndaj një gjyqtari të kësaj gjykate, më datë 04.06.2020, është marrë masa disiplinore e shkarkimit nga detyra prej Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, ndërsa ai ka apeluar vendimin përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelit. Për këtë shkak ky gjyqtar është i pezulluar ‘ex lege’ nga detyra deri në marrjen e vendimit nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, duke përfutur ai pagën në masën 75 për qind të saj, në përputhje me nenin F, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 62, pika 1, të Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa gjyqtari i tretë i kësaj gjykate, më datë 17.07.2017, është komanduar si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë, për një afat 5-vjeçar. Pozicioni i katërt në këtë gjykatë është i lirë në mënyrë të përhershme, në kushtet kur për gjyqtarin që mbante atë, më datë 09.01.2020, është deklaruar mbarimi i statusit të magjistratit.

Në kushtet kur, në Qershor 2020, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë ekzistonin 3 pozicione të lira, një i përhershëm dhe dy të përkohshëm, Këshilli transferoi përkohësisht 2 gjyqtarë nga gjykata të tjera të juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë, duke bërë që aktualisht në këtë gjykatë të jenë në detyrë tre gjyqtarë.

Pas datës 04.06.2020, për shkak të organikës së paplotë, numri i çështjeve për gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë është rritur. Ndërkohë, për shkak të rregullave të përcaktuara nga legjislacioni procedural gjyqësor për formimin e trupave gjykues, në veçanti për gjykimin e çështjeve penale, kjo gjykatë ka një rritje të ndjeshme

të numrit të çështjeve në nevojë për caktim gjyqtarësh nga gjykata të tjera të juridiksionit të përgjithshëm.

Ndodhur në këto kushte, ndërsa në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë kishte një pozicion të lirë të përhershëm, për të ulur efektet negative nga mungesa e organikës së gjyqtarëve, Këshilli, me Vendimin nr. 484, datë 20.10.2020, vendosi shpalljen e pozicioneve të lira për të diplomuarit në përfundim të programit trevjeçar të formimit fillestar në Shkollën e Magjistraturës, në vitin akademik 2019-2020 dhe të emëruar gjyqtarë më datë 20.10.2020, ndër të tjera, edhe për një pozicion të lirë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Tashmë Këshilli e ka caktuar në pozicion një nga gjyqtarët e emëruar më datë 20 tetor 2020. Lidhur me këtë, ky caktim, në fakt, passjell një situatë problematike në lidhje me pagimin e pagave të punonjësve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, për sa kohë do të kapërcehej numri i punonjësve të saj sipas organikës, ndërsa si dhe më lart u parashtrua, në organikën e saj për efekt shpenzimesh në zërin paga, janë përfshirë dhe 2 gjyqtarët e transferuar përkohësisht.

Për të shmangur këtë problematikë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka përgatitur projektvendimin “Për një shtesë në Vendimin nr. 205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë”.

Sipas projektvendimit, pikës 1 të tij, propozohet që pas pikës 2, të Vendimit nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të shtohet pika 2/1, me përmbajtje si vijon “2/1 Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë”. Pra, propozohet që efektet financiare, që në fakt kanë të bëjnë me pagën e gjyqtarit {...}, të përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ku ai ka caktimin e përhershëm, gjykatë e cila disponon fondet e nevojshme financiare, të alokuara asaj për këtë qëllim.

Në pikën 2 të projektvendimit, përcaktohet se efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.10.2020, duke patur në konsideratë se gjyqtarit të emëruar që u caktua tashmë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë, e drejta e pagës do t'i fillojë nga dita e emërimit, data 20.10.2020, për të mundësuar në këtë mënyrë përfundimin normalisht të pagës nga gjyqtari i emëruar dhe caktuar rishtazi, ashtu dhe nga gjyqtari i transferuar përkohësisht.

Pikë 3 e projektvendimit bën fjalë për njoftimin e vendimit gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë dhe botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Lidhur me këtë projektvendim, ndërsa ai ka të bëjë me çështje të karakterit buxhetor dhe financiar, u kërkua dhe u morr një opinion nga Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit pranë Këshillit, të cilin e gjeni bashkëlidhur. Sipas këtij opinioni, projektvendimi "Për një shtesë në Vendimin nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për përsëritjen e transferimit të përkohshëm të gjyqtarit {...} në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kavajë", konkretisht pika 2/1, krijon mundësinë e zbatimit të legjislacionit dhe akteve nënligjore mbi pagat, në harmoni të plotë për të dy gjykatat, atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe atë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Kemi ndonjë diskutim mbi projekt-aktin?

Nëse jo, kalojmë në votim sipas propozimit të bërë nga Komisioni?

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Dakord.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi: 1.Pas pikës 2, të Vendimit nr.205, datë 11.06.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1 Efektet financiare sipas këtij vendimi përballohen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë”.

2. Efektet e këtij vendimi fillojnë nga data 01.10.2020.

3. Njoftimin e këtij vendimi gjyqtarit z. {...}, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, sipas rendit të ditës, sot kemi dy çështje të cilat, ashtu siç kemi rënë dakord, kërkohet që të jenë me dyer të mbyllura, kështu që shkëputet komunikimi “online” për të vijuar me shqyrtimin e këtyre dy çështjeve.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2020

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 28.10.2020)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Ceremonia e betimit të gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020.¹

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:30 dhe mbaroi në orën 12:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Medi Bici | (anëtar) |
| 4. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Marçela Shehu | (anëtare) |
| 11. Erjon Muharremaj | (anëtar) |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. ***Gent Ibrahim, Kryetar i Këshillit të Lartë të Prokurorisë.***
2. ***Sokol Sadushi, Zëvendëskryetar i Gjykatës së Lartë.***
3. ***Artur Metani, Inspektori i Lartë i Drejtësisë.***
4. ***Arben Rakipi, Drejtor i Shkollës së Magjistraturës.***
5. ***Përfaqësues të medias së shkruar dhe audio/vizive.***
6. ***Përfaqësues të misioneve EURALIUS dhe USAID.***

RENDI I DITËS:

7. Ceremonia e betimit të gjyqtarëve të emëruar më datë 20.10.2020.

Ceremonia e betimit të 19 gjyqtarëve të emëruar nis me fjalën përshëndetëse të Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami e cila në emër të Këshillit të Lartë Gjyqësor shprehet:

“Të nderuar gjyqtarë dhe kolegë!

Dua në emër të Këshillit t’ju uroj në këtë ditë të shënuar në jetën tuaj!

Ju uroj suksese dhe kurajë sepse keni zgjedhur sot të jeni gjyqtarë. Të jesh gjyqtar sot nuk është vetëm një status por është një përgjegjësi e madhe. Për çdo çështje që ju do të gjykoni, mijëra qytetarë do t’ju gjykojnë ju. Sot më shumë se kurrë jeni përpara syve të publikut, prandaj ju duhet të ruani figurën tuaj të pastër, integritetin. Ju duhet të punoni çdo ditë për të rritur profesionalizmin dhe cilësinë. Kemi një imazh për të ndryshuar, së bashku!

Ne sot kemi nevojë për ju më shumë se kurrë. Sot për shkak të vakancave në sistem, kemi vetëm 75% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve efektivisht në detyrë dhe gjatë vitit të kaluar 2019, 84/5% e gjykatave kanë funksionuar me kapacitete të reduktuara. Ngarkesa e punës së gjyqtarëve është rritur me ¼ dhe kolegët tuaj kanë gjykuar rreth 120 çështje më shumë në vit. Sot kemi gjyqtarë për 100 000 banorë më pak se 60% e vendeve evropiane.

Ju sot do të bëni një betim të rëndësishëm të cilin do ta kujtoni shpesh në jetën tuaj, veçanërisht sa herë do të keni vendimmarrje të rëndësishme, vështirësi, ngarkesë dhe presion.

Të gjitha këto do t'ju bëjnë gjyqtarë, Çdo ditë, në çdo seancë, në çdo arsyetim dhe në çdo vendim. Por mos harroni që presioni është ai që e bën diamantin nga qymyri.”

Më tej zonja Llagami, fton për një fjalë të shkurtër përshëndetëse z. Sokol Sadushi, Zëvendëskryetar të Gjykatës së Lartë.

Zoti Sadushi ndër të tjera thekson se ndihet krenar për produktin e mirë që ka nxjerrë Shkolla e Magjistraturës. Gjyqtarët e rinj do të përballen me sfida të reja, ku u pret një vështirësi e madhe e cila është e kuptueshme për situatën që ndodhet sistemi i drejtësisë, pasi të gjithë duhet ta dinë që sakrificat janë pranë këtyre magjistratëve. Sistemi ka nevojë për një model tjetër gjyqtari, një model që këta magjistratë të rinj do ta përcjellin me atë që kanë performuar duke bërë që sistemit të ndryshojë në mënyrë graduale. Mundësia është e këtyre magjistratëve dhe e atyre që do të vijnë pas, duke shpresuar që me të vërtetë sistemi i drejtësisë është ai që kërkohet nga të gjithë.

Gjithashtu zoti Sadushi i drejtohet gjyqtarëve të rinj që kur ata të hyjnë në sallën e gjyqit për të gjykuar, mos të harrojnë se do të gjykoen, do të gjykoen nga opinioni publik, ndaj kërkohet rritja e besimit të publikut. Me profesionalizëm, me integritet, me forcë, ata do ta ndryshojnë imazhin drejtësisë dhe sot në këtë moment solemn që do të betohen në Kushtetutë, do të japin shpresën tek të gjithë ata që presin për një drejtësi që do të bëhet.

Më tej fjalën e merr zoti Arben Rakipi, Drejtori i Shkollës së Magjistraturës i cili uron shkurtimisht suksese të gjithë gjyqtarëve të rinj gjatë ushtrimit të detyrës. Ai është i bindur se me përgatitjet dhe aftësitë që këta gjyqtarë kanë do të shënohet rritje dhe përmirësim në sistemin e drejtësisë aq shumë të dëshiruar prej të gjithëve. Gjithashtu ai shprehet se ky çast solemn të kujtohet gjatë pasi do të betohen në Kushtetutën dhe respektimin e ligjeve në tërësi. Ai uron që ky betim, në ditë të vështira t'u ngjallë në përmbytje të tij jo vetëm si një detyrim formal por në përmbytje për të thirrur në ndihmë fjalën e dhënë për respektimin e Kushtetutës dhe ligjeve shqiptare. Betimi do konsiderohet si një akt i shenjtë, si një fjalë e dhënë që do përmbushet hap pas hapi duke arritur në përfundimin e asaj që të gjithë kanë dëshiruar dhe investuar tek këta gjyqtarë, përmirësimin e sistemit si një shërbim në të mirë të vendit.

Në përmbyllje të fjalës së tij zoti Rakipi i uron gjyqtarëve që të jenë të bashkuar

nëpërmjet vendimeve dhe cilësisë së gjykimit duke kontribuar kështu në ngritjen dhe forcimin e një sistemi gjyqësor realisht të pavarur.

Më pas u vijua me betimin e gjyqtarëve të rinj, Znj. Anjeza Buzo, Znj. Alda Sadiku, Znj. Thomaidha Roça, Znj. Jeta Qinami, Znj. Sonila Hoxha, Z. Fatmir Ndreu, Znj. Arjeta Lika, Z. Alban Veçani, Znj. Entela Gjoni, Znj. Suela Lika, Z. Gjergji Baçi, Znj. Marjola Beluli, Z. Aulon Pashaj, Znj. Arnisa Këlliçi, Z. Adrian Shega, Z. Gentian Jahjollli, Znj. Maela Alicanaj, Z. Enkel Peza, Znj. Miranda Nakaj, sipas tekstit: “Betohem solemnisht se gjatë kryerjes së detyrës do t’i qëndroj kurdoherë besnik Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjeve në fuqi dhe do të respektoj rregullat e etikës profesionale”.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor